

Në bazë të nenit 59, të Ligjit për komunikime elektronike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 39/14; 188/14; 44/15; 193/15; 11/2018; 21/18; dhe 98/19) dhe nenit 27, paragrafit 1, pikës 6, të Statutit të Universitetit të Evropës Juglindore, Bordi i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 9.09.2019, e miratoi këtë:

RREGULLORE PËR PËRDORIMIN E RRJETIT TELEFONIK

I. Objekti i rregullimit

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet përdorimi i rrjetit telefonik nga të gjithë personat, të cilët janë në marrëdhënie pune në Universitet, si dhe çështje dhe detyra që kanë të bëjnë me punën zyrtare.

II. Mënyra e përdorimit të rrjetit telefonik

Neni 2

Me qëllim të sigurimit të shërbimit efikas dhe eficient, Sekretari i përgjithshëm rregullon qasjen në rrjet për individët dhe vendet e caktuara të punës, me definimin e autorizimeve për thirrje (lokale, nacionale, ndërkombëtare, celulare).

Neni 3

Përdorimi i telefonave monitorohet vazhdimisht nga Departamenti i TI-së dhe ruajtja e të dhënave rreth shfrytëzimit të tyre bëhet në mënyrë sistematike. Sekretari i përgjithshëm, në çdo kohë, ka autorizim t'iu qaset këtyre të dhënave dhe ka mundësinë për të gjeneruar raporte të ndryshme të shfrytëzueshmërisë për periudha të caktuara kohore.

Neni 4

Nëse përdorimi i telefonit ka tejkaluar autorizimet e përdorimit (si p.sh. përdorim për çështje private), ose nuk është në përputhje me këtë Rregullore, atëherë për këtë informohet Zyra e burimeve njerëzore, e cila mund të jep vërejtje, ose të urdhërojë dënim në lartësi të tejkalimit.

III. Dispozitat përfundimtare

Neni 5

Kjo rregullore hyn në fuqi më 01.10.2019.